

VENDIM
Nr. 20, datë 31.1.2017

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS SË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGJI
UNIVERS” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 6 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.1.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut mbi mos fillimin e procedurës për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Në nenin 6 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” citohet se: “Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERE, çdo person që ka selinë e tij në Shqipëri, dhe me objekt të veprimtarisë aktivitetin e kërkuar për licencim”;

- Shoqëria “Energji Univers” sh.p.k., nuk rezulton që në objekt të veprimtarisë së saj të ketë parashikuar tregtimin e energjisë elektrike.

- Aplikuesi nuk ka të drejtë të aplikojë për një licencë në aktivitetin e tregtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti